

TORS REF. NR. 2022 - 039

Date: 20 Qershor 2022

## TERMAT E REFERENCËS

### Për Shërbim Konsulencë

**Vlerësim i nevojave për ndërhyrje dhe kostot përkatëse për akomodimin e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër në mjediset e shkollës Profesionale Arben Broci, Shkodër**

## HYRJE

### Informacion i përgjithshëm për Save the Children në Shqipëri

Save the Children është organizatë kryesuese në botë e pavarur për fëmijë, që punon në 120 vende të botës. Save the Children mbrojnë jetën e fëmijëve, lufton për të drejtat e tyre dhe i ndihmon ata të përmbushin potencialin e tyre. Save the Children punon së bashku me partnerët për të frymëzuar përpjekje në mënyrën se si bota i trajton fëmijët dhe për të arritur ndryshime të menjëhershme dhe të qëndrueshme në jetën e tyre.

Save the Children ka zbatuar programe në Shqipëri që nga viti 1999. Programet e Save the Children fokusohen kryesisht në Zhvillimin e Arsimit Baze dhe Fëmijërisë së Hershme, Mbrojtja e fëmijëve nga cdo formë shfrytëzimi dhe abuzimi dhe Qeverisja e të Drejtave të Femijes. Puna e Save the Children fokusohet në ngritjen e kapaciteteve, përforcimin e shërbimeve për fëmijët dhe krijimin e politikave dhe të një mjedisi legjislativ që u përgjigjen çështjeve kyçe që lidhen me të drejtat e fëmijëve në vend. Save the Children luan rolin e avokatit të drejtave të fëmijëve dhe kontribuon për permisimin e vendimeve të cilat sjellin ndryshime në të ardhmen e fëmijëve.

**Vizioni ynë:** Një botë në të cilën çdo fëmijë gëzon të drejtën për mbijetesë, mbrojtje, zhvillim dhe pjesëmarrje.

**Misioni ynë:** Të frymëzojmë një revolucion në mënyrën me të cilën bota i trajton fëmijët dhe të mundësojmë ndryshime të menjëhershme dhe të qëndrueshme në jetën e tyre.

**Vlerat tona:** Përgjegjësi, ambicia, bashkëpunimi, kreativiteti dhe integriteti.

Ne kemi marrë angazhimin të sigurojmë që burimet tona të përdoren në mënyrë sa më efektive duke i përqendruar ato në veprimtari që synojnë arritjen e ndikimit maksimal në jetën e fëmijëve.

## PERSHKRIM I PROJEKTIT DHE KONTEKSTI

Projekti **'Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë'** 2022 – 2026 ka për qëllim të fuqizojë adoleshentët dhe të rinjtë të prekur nga pabarazia dhe diskriminimi për një përpjekje më të shpejtë kundër varfërisë, pabarazisë dhe diskriminimit. Nëpërmjet këtij projekti, Save the Children i ofron mundësi të rinjve nga shtesa vulnerabël të aftësohen në mënyrë të qëndrueshme drejt rrugëtimit të tyre në moshën madhore me qëllim ndërprerjen e ciklin të varfërisë. Save the Children në partneritet me Organizatën Jofitimprurëse 'Ndihmë për Fëmijët' po ndërmarrin nisma dhe aktivitete në drejtim të ofrimit të mundësive këtyre të rinjve për përmirësimin e mirëqënies nga ana arsimore, shëndetësore, mbrojtjes dhe mundësive për zhvillim e punësim dinjitoz nëpërmjet:

**Save the Children in Albania**  
**National Office**

Rr. Mihal Popi, Ndertesa 7, ish Pallatet I Maji,  
Vila "Lami"; P.O. Box 8185, Albania  
E-mail: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org)

Registered in Albania

Telephone: +355 4 2261840/

+355 42261929/+355 4 2266227

Web Page: [albania.savethechildren.net](http://albania.savethechildren.net)

- shkollimit e aftësimin profesional, aftësim për jetën;
- integrim në tregun e punës dhe programe trajnimi mbi sipërmarrjen;
- mbështetje me pajisje, materiale e ngritje kapacitetesh në 3 shkolla profesionale (Cërrik, Shkodër dhe Dibër) dhe 3 Qendra Rajonale të Formimit Profesional Publik (Elbasan, Shkodër, Dibër – qendër levizëse)
- ndihmësë në përmirësimin e kurikulave të shkollës profesionale dhe Qendrave të Formimit Profesional.

Qasja e zbatimit të projektit është partneriteti dhe bashkëpunimi i ngushtë me njesitë e qeverisjes vendore (bashki dhe njesitë e tyre vartëse) si dhe institucionet vartëse të Agjencive Kombëtare në fushën e arsimit, formimit profesional e punësimin.

Për të rritur # e të rinjve që frekuentojnë kurset e formimit profesional dhe ofrimin sa më cilësor të këtyre kurseve, Projekti në bashkëpunimi me Agjencinë Komëbëtare të Punësimin dhe Aftësive (AKPA) do të mundësojë akomodimin e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër në mjediset e Shkollës Profesionale Arben Broci (Shkodër), pasi mjediset fizike aktuale janë të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur kërkesave për kurse profesionale. Mjediset fizike në shkollën Profesionale 'Arben Broci' ofrojnë mundësi reale për të akomoduar kurset e shumëllojshme profesionale por nevojitet që këto mjedise (kapanone me përmasa të mëdha) të përshtaten sipas nevojave specifike që klasat/laboratorët e Qendrës së Formimit Profesional duhet të përmbushin. Ministria e Financave ka leshuar shkresën 'Urdher', datë 11 Maj 2022, për akomodimin e veprimtarisë së Formimit Profesional – drejtoria Rajonale Shkodër në mjediset e shkollës profesionale Arben Broci. Sipas planimetrisë të vënë në dispozicion nga drejtoria e Shkollës Profesionale Arben Broci, mjediset e vëna në dispozicion për akomodimin e klasave/laboratoreve të Qendrës së Formimit Profesional në shkollën Arben Broci janë të etiketuara si sipërfaqje e 'Mekanikës', ndërsa mjediset për administratën e Qendrës së Formimit Profesional janë të etiketuara si sipërfaqje e 'Administratës'. Objekt kryesor për këtë detyrë do të përbëjë sipërfaqja e etiketuar si "Mekanika", e cila do të shërbejë kryesisht për përshtatje për klasat/kabineteve ku do të zhvillohen kurset profesionale.

## OBJEKTIVAT E KONSULENCËS

Save the Children kërkon të kontrakttojë një konsulent (inxhinier/arkitekt të licensuar) i cili pasi të vizitohet mjediset e paracaktuara për akomodim të veprimtarisë së Formimit Profesional, sipas Urdhërit të Ministrisë së Financave nr 146, datë 11 Maj 2022 dhe të zhvillojë takime me Drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër dhe Drejtorinë e Menaxhimit të AFP-së në AKPA:

- Te hartojë një 'Raport Teknik' për nevojat për nderhyrje me qëllim që mjediset e shkollës Arben Broci (kryesisht sipërfaqja e etiketuar si 'Mekanika') të funksionojnë në mënyrë optimale (nga ana fizike dhe e sigurisë) për organizimin e kurseve të formimit profesional:
  1. Klasa/laboratorë funksionale sipas standardeve dhe numrit të nevojshëm të kursantëve (min 7; max 15 kursantë), duke optimizuar sipërfaqjet për planifikimin e klasave/kabineteve funksionale
  2. Ndrësim të nevojshëm me drite natyrale dhe elektrike për mjediset e klasave/laboratorëve;
  3. Rrjet elektrik dhe interneti të përshtatshëm për funksionimin e pajisjeve laboratorike nëpër klasa/laboratore dhe në zyrat e administratës
  4. Tualet të përshtatshme dhe funksionale të ndara nga ana e **gjinisë** dhe që plotësojnë **standardet për funksionim nga ana e personave me aftësi të kufizuara**.
  5. Të lërë në dispozicion të administratës ambiente të nevojshme për zyrën e drejtorit, zyrën e sektorit mbështetës (financa, juristi, magazinieri), zyrën e njesisë së zhvillimit, sekretarinë, arkivat, magazinën dhe një sallë për takime/mbledhje
  6. Përshtatshmeria e klasave/laboratoreve për të shmangur barrierat dhe për të realizuar aksesin fizik të personave me aftësi të kufizuara (rampe; teknologji ndihmëse, etj)



- b) Të përcaktojë nëpermjet një preventivi volumin e punimeve dhe vlerën e ndërhyrjeve
- c) Të përgatisë 'Projektin e Zbatimit' me të gjitha hollësitë për ndërhyrjet e pikës a) duke përfshirë edhe raportet teknike, preventivat e punimeve, specifikimet teknike
- d) Të hartojë një dokument me të gjithë dokumentacionin që kërkohet për tenderimin e kësaj ndërhyrje.
- e) Të marrë parasysh në hartimin e raportit teknik:

e1. Listën e kurseve të vlefshme që ofron Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional, Shkodër



Microsoft Word 97  
- 2003 Document

- e2. Standardet e përgjithshme të ofrimit të kurseve
- e3. Grupimin e kurseve profesionale të cilat mund të ofrohen në mjedisin e një klase të përbashket (ky dokument do të prezantohet nga Drejtoria Rajonale e Formit Profesional Publik)
- e4. Listë të përcaktimit të vendodhjes se kurseve nëpër kate (k. perdhe vs kati I parë) që do ofrohen në mjediset që janë objekt projektimi dhe listë të kurseve që mund të ofrohen ne mjediset që I përkasin shkollës A. Broci. (ky dokument do të prezantohet nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik)

## METODOLOGJIA DHE VENDODHJA

Konsulenti do punojë ngushtësisht me stafin përgjegjës pranë Save the Children, Drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale të Formit Profesional Publik (Shkodër) dhe sipas nevojës me drejtorinë e Formimit Profesional të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) për të kuptuar më mirë standardet e përgjithshme të ofrimit të kurseve profesionale dhe vlerësuar sa me saktë nevojat.

Konsulenti do të përmbushë detyrat e caktuara në Bashkinë Shkodër, në mjediset e Shkollës Profesionale Arben Broci.

Sipas planimetrisë së mjedisit të paracaktuar, sipërfaqja në dispozicion është si vijon:

### Seksioni i Parë (Mekanika) – ambientet e së ciles do të akomodohen për klase e laboratorë

- Kati Perdhe = ambiente për klase/kabinete (322 m<sup>2</sup>), tualete (15 m<sup>2</sup>), shkallë e koridore (44 m<sup>2</sup>)
- Kati Pare = klase/salla (200m<sup>2</sup>); koridor (54m), shkalle (25m<sup>2</sup>)

### Seksioni i Dytë (Administrata) – këto ambiente do të qëndrojnë për zyra (nëse % e caktuar e kësaj sipërfaqeje do të përdoret për klase/laboratorë, kjo sipërfaqje do të futet në sipërfaqjen për akomodim të kurseve)

- Kati Perdhe = Koridor 16.5 m<sup>2</sup>, shkalle 19.5m<sup>2</sup>, sip ndihmëse 8m<sup>2</sup>
- Kati Pare = salla për zyra (196m<sup>2</sup>), koridor 56m<sup>2</sup>, shkallë 12 m<sup>2</sup>

## SHERBIMET QE DO PËRMBUSHË KONSULENTI

- Vizitë për konsultime me stafin përkates të Qendrës së Formimit Profesional Publik- Shkodër në mjediset e shkollës Arben Broci dhe konsultime me Drejtorinë e Menaxhimit të AFP në AKPA
- Vështrim I standardeve të përgjithshme të ofrimit të kurseve



- Vlerësim i nevojave për ndërhyrje nga aspekti teknik të paraqitura në Objektivat e Konsulencës
- Vlerësim i volumit të punës së kërkuar bazuar tek konsultimet dhe rënies dakort me stafin perkates të Save the Children dhe Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik (Shkodër)
- Përgatitje të preventivit për ndërhyrjet duke përcaktuar sasinë dhe vlerën e tyre dhe duke e rishikuar këtë vlerë sipas shumës së buxhetit që Save the Children ka planifikuar të vendosë në dispozicion.
- Përgatitje të dokumentit për dokumentacionin e kërkuar për tenderim të kësaj ndërhyrjeje

## REZULTATET/PRODUKTET E PRITSHME

- Raport teknik për nevojat për ndërhyrje (kryesisht për klasat/kabinetet për kurse profesionale)
- Projekti i zbatimit me specifikimet teknike (Ëord document)
- Projekt Zbatimi sipas planimetrive përkatëse të dhomave/klasave dhe vizatimeve (përfshire dhe foto të gjendjes ekzistuese)
- Preventiv I punimeve
  - a. (dokumenti me volume punimesh dhe cmime reference)
  - b. (dokumenti vetëm me volume punimesh)
- Hartimi I dokumentacionit të kërkuar për tenderim

## PERJEGJESITE E SAVE THE CHILDREN

- Koordinim me Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik (Shkodër) dhe përfaqësues të AKPA
- Dhënie opinionesh dhe mendimesh lidhur me dokumentin dhe preventivin e vlerësimit të propozuar

**Nëpërmjet ndihmesës së Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik, Shkodër do të ofrojë:**

- Listën e grupimit të kurseve profesionale të cilat mund të ofrohen në mjedisin e një klase të përbashkët
- Listë të percaktimit të vendodhjes së kurseve nëpër kate (k. perdhe vs k. I parë) që do ofrohen në mjediset që janë objekt projektimi dhe listë të kurseve që mund të ofrohen në mjediset që I përkasin shkollës A. Broci.

**Vendi :** Shkodër

## PERIUDHA E SHËRBIMIT TE KONSULENCËS

30 Qershor – 13 Korrik 2022

## INFORMACIONI PËR PAGESËN

Tarifa e shërbimit mund të llogaritet:

- Dite pune për efekt pagese per konsulentin: X EURO/ditë pune ose
- X EUR/m2 sipas siperfaqjes e cila është objekt për përshtatje.

Sipërfaqja që do të jete objekt projektimi përmban kryesisht sipërfaqjen e etiketuar si 'mekanika' dhe përfshin sipërfaqje në katin përdhe dhe në katin e pare, të tilla si salla/kabinete e tualete. Kjo sipërfaqje përafersisht është 537-550 m2. Në varësi të nevojës të përfshirjes në projektim të % të caktuar të sipërfaqjes të etiketuar e planifikuar si 'administrata', sipërfaqja e seksionit 'administrata' që mund të bëhet pjesë e projektimit është deri në 196 m2.

**Në përfundim të punës së kryer, konsulenti duhet të lëshojë një faturë (fature e fiskalizuar, e njohur nga Drejtoria e Tatimeve) sipas shumës së rënë dakort.**



## **POLITIKA E MBROJTJES SE FEMIJEVE, SAVE THE CHILDREN**

Konsulenti duhet të nënshkruajë Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve, të Save the Children dhe zbatojë termat dhe kushtet e kësaj politike.

### **KUALIFIKIMI DHE ESKPERIENCA E KERKUAR**

- diplomë për inxhinjeri ndërtimi ose arkitekturë
- liçensë përkatëse për projektim/vlerësim punimesh
- eksperiencë të ngjashme (e preferueshme për vlerësim nevojash/projektme të institucioneve arsimore ose arsimore profesionale) me minimum 10 vjet eksperiencë

### **APLIKIMI**

Personat e interesuar mund të dorezojnë aplikimin e tyre në mënyre elektronike te [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org) brenda datës 27 Qershor 2022, ora 17:00 me titull aplikim:

**Shërbim Konsulencë: ‘Vlerësim i nevojave për ndërhyrje dhe kostot përkatëse për akomodimin e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër në mjediset e shkollës Profesionale Arben Broci, Shkodër’**

Aplikimi duhet të përmbajë:

- 1 CV
- 2 Diplomë për inxhinjeri ndërtimi ose arkitekturë
- 3 Liçensë për projektim/vlerësim punimesh
- 4 NIPT
- 5 Dokument ku shënohet oferta e punës së projektimit (vlerë totale dhe e detajuar: EURO/dite pune ose EURO/ m2)
- 6 Deklaratë disponibiliteti/gadishmërie për kryerjen e konsulencës sipas afatave në këtë TOR
- 7 Referencë të punëve të ngjashme (raporte teknike/foto ne PDF ose ëeb links)

---

### **ANEKSE:**

**Modeli i Raporteve:**

**1. Specifikime teknike të Projekt Zbatimit (Word document)**

**2. Projekt I Zbatimit**

- 00 - KOPERTINA
- 01 - TABELA E FLETËVE TË VIZATIMIT
- 02 - FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE
- 03 - PLANIMETRIA E DIMENSIONUAR, KATI PERDHE - GJENDJA EKZISTUESE
- 04 - PLANIMETRIA E NDËRHYRJEVE - KATI PËRDHE
- 05 - PLANIMETRIA E DIMENSIONUAR KATI PËRDHE
- 06 - PLANIMETRIA E MOBILUAR KATI PERDHË
- 07 - PLANIMETRIA E DIMENSIONUAR - KATI PARË - GJENDJA EKZISTUESE
- 08 - PLANIMETRIA E NDËRHYRJEVE – KATI I PARË
- 09 - PLANIMETRIA E DIMENSIONUAR - KATI I PARË
- 10 - PLANIMETRIA E MOBILUAR - KATI I PARË



- 11 - PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE, RRJETI ELEKTRIK DHE RRJETI I NDRICIMIT
- 12 - PLANIMETRIA E KATIT TË PARË, RRJETI ELEKTRIK DHE RRJETI I NDRICIMIT
- 13 - PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE, RRJETI I MONITORIMIT ME KAMERA
- 14 - PLANIMETRIA E KATIT TË PARË, RRJETI I MONITORIMIT ME KAMERA

### 3. Anekse

- 3.1. Lista e Kurseve Profesionale (2022)
- 3.2. Lista e grupimin të kurseve profesionale të cilat mund të ofrohen në mjedisin e një klase të përbashkët
- 3.3. Lista e percaktimit të vendodhjes së kurseve nëpër kate
- 3.4. Planimetria e ofruar: Kati përdhe; Kati I parë (bashkëngjitur më poshtë)
- 3.5. Foto orientuese të mjedisit për akomodim

#### 3.1 Lista e Kurseve Profesionale (2022)

NR	EMËRTIMI I KURSIT
1	INSTALIME DHE MIRËMBAJTJE HIDRAULIKE
2	INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE E RRJETIT ELEKTRIK
3	INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE E SISTEMEVE NGROHËSE FTOHËSE
4	INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE E PANELEVE DIELLORE
5	INSTALIM I PANELEVE DIELLORE FOTOVOLTAIKE
6	SERVIS MOTORI NË AUTOMJETET E LEHTA
7	SERVIS ELEKTROAUTO NË AUTOMJETE TË LEHTA
8	SALDIM
9	RIPARIM ELEKTROSHTËPIAKE
10	MODELIM VESHJE PËR FEMRA
11	RIPARIM I MAKINAVE QEPËSE
12	PARUKERI
13	BERBER
14	MANIKYR PEDIKYR
15	SEKRETARI
16	RECEPSION
17	KUZHINË
18	SHËRBIME NË BAR DHE RESTORANTE
19	UDHËRRËFIM TURISTIK
20	SIPËRMARRJE DHE MENAXHIM I BIZNESIT TË VOGËL
21	SIPËRMARRJE DHE ZHVILLIMI I PLANIT TË BIZNESIT
22	TEKNIKË RRJETI KOMPJUTERIK
23	GRAPHIC DESIGN
24	MOBILERI
25	ANGLISHT
26	GJERMANISHT
27	START SMART

#### 3.2 Lista e grupimit të kurseve profesionale të cilat mund të ofrohen në mjedisin e një klase të përbashkët (ofrohet nga QPF Shkoder)



**3.3** Lista e përcaktimit të vendodhjes së kurseve nëpër kate (ofrohet nga QFP Shkodër)

**3.4** Planimetria e ofruar: Kati përdhe; Kati I parë (shiko më poshtë në PDF)



Adobe Acrobat  
Document



Adobe Acrobat  
Document

**3.5** Foto orientuese të mjedisit për akomodim

